REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr.2638/5 Prot. Vlorë më, 01.10.2026

VENDIM

Nr.54, datë 01.10.2026

PËR

RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË "BACHELOR" NË INXHINIERI MEKANIKE, NË MASËN DERI NË 20%, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE, NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË

Në mbështetje të nenit 25, pika 7, nenit 38, pika 1, shkronja "dh", dhe nenit 75 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; nenit 10, pika 6, dhe nenit 19, pika 1, shkronja "ë", të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; Udhëzimit nr. 1 të MAS, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve"; VKM-së nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", e ndryshuar; si dhe referuar propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmëse Akademike, përcjellë me shkresën nr. 2582/1 prot., datë 01.10.2026, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 01.10.2026,

VENDOSI

1. Të miratojë riorganizimin, deri në masën 20%, të Programit të Studimit të Ciklit të Parë "Bachelor" në Inxhinieri Mekanike, në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, sipas dokumentacionit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse të tij.

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

1. Ndryshime në kredite dhe ristrukturim i lëndëve:

1. "Mekanika e aplikuar në makina" nga 6 kredite të riorganizohet në "Mekanika e aplikuar në makina I", me 12 kredite.
2. "Mekanika e materialeve", me 6 kredite, dhe "Projektimi i sistemeve mekanike", me 6 kredite, të riorganizohet në "Mekanika e materialeve dhe Projektimi mekanik I", me 12 kredite.
3. "Sistemet energjitike", me 6 kredite, dhe "Makinat me fluid", me 6 kredite, të riorganizohet në "Sistemet energjitike dhe Makinat me fluid", me 12 kredite.
4. "Mekanika e trupave të ngurtë dhe strukturave", me 12 kredite, të të riorganizohet në "Shkenca e konstruksioneve", pa ndryshime në kredite.
5. "Teknologji mekanike", me 6 kredite, të riorganizohet në "Teknologji mekanike I", pa ndryshime në kredite.
6. "Hyrje në ekonomiks", me 6 kredite, të riorganizohet në "Ekonomi dhe organizim ndërmarrje", pa ndryshime në kredite.
7. "Praktikë profesionale", me 3 kredite, të riorganizohet në "Trajnim dhe Praktikë profesionale", pa ndryshime në kredite.
8. Në grupin e lëndëve me zgjedhje, lënda "Sistemet e transportit" 12 kredite të riorganizohet në "Aplikime Kompjuterike në Inxhinieri Mekanike", pa ndryshime në kredite.

Totali i krediteve të ndryshuara: 12 kredite, që përbëjnë 6.67% të programit të studimit, i cili përmban gjithsej 180 kredite.

2. Ndryshime organizative në shpërndarjen e lëndëve sipas viteve akademike:

1. Lënda "Anglisht/Italisht" do të zhvillohet vitin e parë, në semestrin e parë.
2. Lënda "Teknologji mekanike I" të zhvillohet në vitin e dytë, semestri i dytë.
3. Lënda "Mekanika e aplikuar në makina I" do të zhvillohet në vitin e dytë, semestri i dytë.
4. Lënda "Sistemet energjitike dhe Makinat me fluid"do të zhvillohet në vitin e tretë, semestri i parë.
5. Lënda "Mekanika e materialeve dhe Projektimi mekanik I" të zhvillohet në vitin e tretë, semestri i parë.
6. Lënda "Matje mekanike dhe termike" të zhvillohet në vitin e tretë, semestri i dytë.
7. Lënda "Impiante mekanike I" të zhvillohet në vitin e tretë, semestri i parë.
8. Grupi i lëndëve me zgjedhje të riorganizohet në vitin e tretë, semestri i dytë.

Këto ndryshime bazohen në logjikën progresive të ndërtimit të njohurive dhe synojnë përmirësimin e organizimit akademik të programit.

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

3. Rishpërndarja sipas kategorive të veprimtarive formuese (në përputhje me Shtojcën nr. 1 të nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"):

- Kategoria A – Lëndët bazë: 20% nuk ka ndryshime.
- Kategoria B – Lëndë karakterizuese: 51.67%.
- Kategoria C – Lëndë ndërdisiplinore: 13.33%.
- Kategoria D – Lëndë plotësuese: 11.67%.
- Kategoria E – Diplomë/Provim përfundimtar: 3.33% nuk ka ndryshime.

Riorganizimi i propozuar nuk sjell ndryshime në numrin e krediteve të këtyre kategorive dhe nuk prek strukturën e përgjithshme të programit të studimit.

2. Bashkëlidhur këtij vendimi gjendet plani mësimor i riorganizuar.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektori Akademik, Dekani i Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore, si dhe Drejtoria e Shërbimeve Ndihmëse Akademike.
4. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet për dijeni Ministrisë së Arsimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Aurela Saliaj